



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 dhjetor 2013  
Nr. ref.: RK532/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI159/13**

Parashtrues

**Ferat Neziri**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Ferat Neziri nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin ASC-11-0069 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji për Ankesa i Dhomës së Posaçme), të 22 prillit 2013.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit, i cili pretendohet se i pamundëson parashtruesit të kërkesës që ta realizojë të drejtën në pjesën e 20% nga privatizimi i Ndërmarrjes shoqërore “Ramiz Sadiku” (në tekstin e mëtejme: NSH “Ramiz Sadiku”), në Prishtinë.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 14 tetor 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 28 tetor 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 8 nëntor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë dëshmi se kur i është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar.
8. Më 11 nëntor 2013, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme u njoftua për regjistrimin e kërkesës.
9. Parashtruesi i kërkesës nuk është përgjigjur në kërkesën e Gjykatës të 8 nëntorit 2013.
10. Më 5 dhjetor 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Parashtruesi i kërkesës ishte në marrëdhënie pune në NSH „Ramiz Sadiku“ prej 8 shtatorit 1977 deri më 5 mars 1990.
12. Më 27 qershor 2006, NSH „Ramiz Sadiku“ e përfundoi procesin e privatizimit.

13. Më 13 mars 2009, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër listës përfundimtare të punëtorëve, të cilën e ka hartuar Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Agjencia), pasi që ai si punëtor i mëparshëm nuk ishte i përfshirë në atë listë.
14. Në ankesën drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, parashtruesi kishte theksuar se ai kishte punuar në NSH „Ramiz Sadiku“ më tepër se 12 (dymbëdhjetë) vjet dhe si dëshmi të këtij pretendimi ai e kishte bashkangjitur librezën e tij të punës.
15. Në shkresën dërguar Dhomës së Posaçme, Agjencia ishte përgjigjur në ankesën e parashtruesit, duke theksuar se parashtruesi nuk i plotëson kushtet për të qenë në listën e punëtorëve, të cilët e kanë realizuar të drejtën për një pjesë të 20% nga privatizimi, sepse në regjistrin e Agjencisë gjendet kopja e vendimit, në bazë të të cilit konstatohet se më 5 maj 1994, parashtruesi kishte fituar të drejtën në pension invalidor. Për më tepër, Agjencia, në bazë të shqyrtimit të dokumenteve, kishte vërtetuar se parashtruesi është i lindur më 1 maj 1938, ndërsa në kohën e privatizimit ai i kishte mbushur 65 vjet.
16. Më 15 mars 2010, gjatë procedurës së dëgjimit para Trupit gjykues të Dhomës së Posaçme, parashtruesi vërtetoi pretendimet e Agjencisë dhe përsëriti se në bazë të vendimit të vitit 1994, ai është në pension invalidor të shkallës I (së parë).
17. Gjithashtu, Trupi gjykues në bazë të dokumentacionit në dispozicion dhe shqyrtimit të dokumentit personal identifikues të parashtruesit vërtetoi se ai është lindur më 1 maj 1938, dhe kështu në momentin e privatizimit, ai ishte më i vjetër se 65 vjeç, me ç'rast ai kishte fituar të drejtën për pension të pleqërisë.
18. Më 10 qershor 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme nxori Vendimin SCEL-09-0001, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.
19. Në arsyetimin e vendimit të tij, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme theksoi: *“se gjatë procedurës së dëgjimit dhe marrjes së provave kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës në momentin e privatizimit të NSH „Ramiz Sadiku“ (i cili është bërë më 27 qershor 2006) ai kishte pasur më shumë se 65 vjet. Prandaj, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme konsideron se ankesa e parashtruesit të kërkesës nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13“.*
20. Më 22 mars 2012, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme ndaj Vendimit të Trupit gjykues të Gjykatës Supreme, SCEL-09-0001.
21. Më 22 prill 2013, Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin ASC-11-0069, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar.

## Ligji relevant

22. Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2003/13, e 9 majit 2003, MBI TRANSFORMIMIN E SË DREJTËS PËR PËRDORIMIN E PRONËS SË PATUNDSHME NË PRONËSI SHOQËRORE

Neni 10.4 (Të Drejtat e të Punësuarve)

*„Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6.“*

## Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi në kërkesën e tij nuk specifikon se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë i janë shkelur me vendimin e kontestuar, por vetëm thekson se ai është viktimë e diskriminimit.
24. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me propozim:

*„Që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të nxjerrë aktgjykim me të cilin do të ma pranojë të drejtën në 20% nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku“.*

## Vlerësimi i pranueshmërisë

25. Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të vendosë për kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*„7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.“*

27. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në AKP dhe më vonë edhe në Trupin gjykues dhe Kolegjin për Ankesa të Dhomës së Posaçme. Parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me nenin 113. 7.

28. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili parasheh:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të llogaritet që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor (...).”*

29. Gjykata gjithashtu merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*

*...*

*b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtruesi...”.*

30. Në bazë të dokumenteve të dorëzuara, Gjykata konstaton se parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij më 14 tetor 2013, por meqenëse parashtruesi nuk është përgjigjur në kërkesën e Gjykatës dhe nuk kishte ofruar dëshmi se kur i është dorëzuar aktgjykimi, Gjykata do të llogarisë si datë të dorëzimit të aktgjykimit datën kur Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme e nxori Aktgjykimin ASC-11-0069, dhe në këtë rast është 22 prilli 2013, dhe rrjedhimisht parashtruesi e kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë 1 muaj dhe 22 ditë pas afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores.

31. Nga kjo rrjedh se kërkesa është e paafatshme.

32. Prandaj, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113. 7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit, dhe rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, më 5 dhjetor 2013, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Ivan Čukalović



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani